



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M
Nr. 61, date 28.12.2020

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË
SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ATO INDIVIDË/FAMILJE QË NUK
PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje nenit 24 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 „Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; neni 39, pika 3 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendor, VKM nr. 362 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij“, VKB nr. 26 datë 30.12.2019 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2023 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, VKB nr. 3 datë 22.01.2020 "Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social, për vitin 2020", VKB-së nr. 26 datë 26.06.2020 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë në treg të lire”, “Procesvebalit përfundimtar të Komisionit të Strehimit nr.3547/b/2 prot. datë 13.11.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve për programin e subvencionimit të qirasë në tregun e lirë”, si dhe relacionit të hartuar nga administrata bashkisë me 35 vota Pro,

V E N D O S I

1. Të miratojë listën e përfituesve dhe vlerën e subvencionit të qirasë (bonus i strehimit) për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në e tregut të lire sipas tabelës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare), nga data e lidhjes së kontratës së qirasë, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën totale prej **515,400** (pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë dhe në vlerën **42,519** (dyzet e dy mijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë në muaj, do të përballohen nga fondi i përcaktuar të buxhetit të bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr. 26 datë 30.12.2019 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2023 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar (programi buxhetor: 10661 (Strehimi Social), projekti: P10661.O2.A1).
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit


Denis Lesha

KRYETARE



Tabelë:

Lista e përfituesve dhe vlera e subvencionit të qirasë për ato individë/familje që do të trajtohen me subvencion të qirasë në tregun e lirë.

Nr	Emër	Atësi	Mbiemër	Përbërja Familjare	Struktura e Apartamentit	Sipërfaqja	Qiraja mesatare	Të ardhurat Familjare mujore	Kategoria	Aftësia përballuese	Qiraja e përballuashme	Subvencioni
1	Suelë	Ferid	Qerreti	3	1+1	80 m ²	15,000	0	ç	0%	0	15,000
2	Rudina	Osman	Emini	4	2+1	58 m ²	17,250	0	ç	0%	0	17,250
3	Sebije	Isuf	Mani	1	Garsioniere	58 m ²	10,700	0	ç	0%	0	10,700
Totali											42,950	

Vlera e Subvencionit: 42,950 x 12 muaj = 515,400 Lekë

